



Rrjeti CSR Kosova

Buletini
Informativ

Rreth Rrjetit CSR të Kosovës

Rrjeti për Përgjegjësi Shoqërore Korporative (CSR) është rrjeti i parë i bizneseve i themeluar në Kosovë për CSR nga anëtarët themelues së tij. Rrjeti është themeluar me 21 Prill të vitit 2011 nga udhëheqës të shquar të bizneseve Kosovare dhe ndërkombëtare që kanë qenë të përkushtuar ta rrisin vetëdijen e publikut në CSR dhe në përfshijë praktikat më të mira të CSR në kompanitë e tyre. Edhe pse tani një organizatë relativisht e vogël, rrjeti kërkon të rritet dhe të bëhet një rrjet stimulues që tërheq biznese të reja në promovimin e CSR në tërë Kosovën.

Rrjeti i CSR në Kosovë është anëtar i Rrjetit për Përgjegjësi Shoqërore Korporative të Evropës (CSR Europe), i cili është një hap tjetër i Rrjetit të integroj tutje organizatat kosovare në strukturat evropiane.

Rrjeti për Përgjegjësi Shoqërore Korporative synon të përputhet me 10 principet e "Global Compact" që është kornizë e bazuar në principet për bizneset, duke deklaruar dhjetë principe në fushat e të drejtave njerëzore, ambientit dhe anti-korrupsionit. Mbrojtja e të drejtave njerëzore, të mbrojtura ndërkombëtarisht, eliminimi i punës së fëmijëve, promovimi i projekteve ekologjikisht miqësore, eliminimi i diskriminimit të lidhur me punë apo profesion dhe promovimi i vlerave anti-korruptive janë disa prej fushave që Rrjeti CSR ka për qëllim t'i adresojë.



Rrjeti CSR është i përkushtuar ta pranojë përgjegjësinë për veprat e kompanisë dhe inkurajimin e ndikimit pozitiv përmes aktiviteteve tona në lidhje me mjedis, konsumatorë, punëtorë, komunitete, palëve të interesuara dhe publikut të gjerë.



Rrjeti CSR Kosova po ofron pozita praktike për persona të prekur me Sindromin Down

Kompanitë anëtare të Rrjetit CSR Kosova (Kosovo CSR Network) kanë siguruar pozita praktike 1 mujore, me pagesë, për persona të prekur me Sindromin Down, për të ndihmuar në aftësimin e tyre dhe integrimin e tyre në shoqëri. Praktikantët e punësuar si përgaditje kanë përfunduar trajnime për aftësim nga Down Syndrome Kosova. Rrjeti CSR Kosova synon të krijoj një momentum në shoqërinë Kosovare për rritje të rëndësishme të Përgjegjësisë Shoqërore të ndërmarrjeve në adresimin e shumë sfidave të aspektit shumë dimensional, përfshirë: të drejtat e njeriut; të drejtat e punëtorëve; mjedisin; luftimin e korrupsionit; dhe çështjet e ndryshme të karakterit social. Drejtoresha Ekzekutive e CSR Kosova, Linda Tahiri Rukiqi, ka falënderuar anëtarët e rrjetit për gatishmërinë që kanë treguar dhe kontributin e tyre në aktivitete të Përgjegjësisë Shoqërore. Ajo shtoi se pozitat praktike të ofruara do të ndihmojnë në aftësimin e praktikantëve për punë si dhe drejt krijimit të një jete të pavarur prej të rrituri. Praktikantët po kryejnë punë nga më të ndryshmet. Gentriti, praktikant në **Bankën Raiffeisen**, është angazhuar

në detyra si: fotokopjim, printim, arkivim të dokumenteve të caktuara, përfshirje në aktivitete sociale që ndërlidhen me punën, si Panairi i Punës ku ka bërë shpërdarjen e fletushkave dhe materialeve tjera promovuese dhe përkrahëse. Agroni, është praktikant në **American School of Kosova**, i cili i asiston arsimtarët në klasë dhe angazhohet në kantinën e shkollës. Stafi dhe fëmijët në ASK tani janë familjarizuar me Agronin dhe këtij të fundit po i pëlqen shumë puna, andaj stafi i ASK kanë vendosur që t'ia zgjasin praktikën edhe për një muaj shtesë ku për muajin e dytë vetë stafi kanë mbledhur të hollat për pagën e tij. Linda, praktikante e rekrutuar nga **Korporata Rugove**, angazhohet kryesisht në arkivim dhe fotokopjim të dokumenteve, dhe deri më tani e ka kryer punën pa asnjë problem. Albioni, e ka përfunduar punën praktike në **Odën Ekonomike Amerikane**, e cila ka zgjatur një muaj. Përmes kësaj mundësie, Oda Amerikane ka mbështetur ofrimin e aftësimin të Albionit në ambientin e punës duke e njoftuar atë me procesin e punës dhe aktivitetet të cilat Oda Amerikane i zhvillon. Përveç këtyre praktikantëve, në muajt në vazhdim anëtarët e Rrjetit CSR Kosova do të ofrojnë edhe pozita të tjera praktike për persona të prekur me Sindromin Down.



Banka ProCredit mbështet ndërtimin e Qendrës për Edukim Mjedisor “Thesarët e Natyrës”

Banka ProCredit ka mbështetur ndërtimin e Qendrës për Edukim Mjedisor në kuadër të Pyllit të Arinjëve (fshati Mramor, afër liqenit të Badovcit). Qendra ka për qëllim që përmes edukimit joformal dhe interaktiv të promovojë mbrojtjen e ambientit në Kosovë;

Banka ProCredit ka mbështetur këtë projekt inovativ ku ka financuar lidhjen e qendrës me sistemin e furnizimit me rrymë dhe instalimin e paneleve solare fotovoltaike me kapacitet 30KW, 120 panele solare.

Ky investim planifikohet që të mbulojë 20% të energjisë së shpenzuar të Qendrës; Vlera e projektit që banka ka participuar është 67.000 Euro.



“Për bankën ProCredit, ky projekt është i një rëndësi të veçantë meqë në njërin anë shprehë dedikimin e vazhdueshëm të bankës në mbrojtje të mjedisit, element i pandarë i identitetit tonë dhe në anën tjetër konfirmon tutje pozicionin tonë për përgjegjësi sociale” është shprehur drejtori gjeneral i bankës ProCredit Ilir Aliu.

Banka ProCredit e dedikuar në Mbrojtje të Ambientit

Oasja e përgjegjshme në mbrojtjen mjedisore është pjesë e rëndësishme e modelit të përgjegjshëm biznesor e shoqëror të Bankës ProCredit dhe vlerë e integruar në filozofinë bankare. Standardet mjedisore të bankës ProCredit kanë për qëllim uljen e ndikimit negativ në mjedis op aktivitetet tona, integrimin dhe zbatimin e procedurave ekologjike miqësore në një sistem.

A e dini se?

55 milion Euro (11%) nga të gjitha kreditë e bankës ProCredit janë të dedikuara financimit të investimeve EKO.

63% të veturave të bankës ProCredit janë EKO, Hibride dhe Elektrike. Deri në fund të vitit 2018 e tërë flota e veturave do të përbëhet nga veturat Hibride ose Elektrike

Mbi 100,000 Euro Banka ProCredit ka investuar në rregullim të parqeve dhe kemi mbjellë mbi 500 drunj.

Gjatë 2017 banka ProCredit ka ricikluar 66 ton të mbetjeve elektronike dhe 56 ton të mbetjeve të letrave.

82% është ulur përdorimi i letrës në bankën ProCredit krahasuar me vitin 2011.

61% janë ulur shpenzimet e ngrohjes dhe energjisë krahasuar me vitin 2011.

61% janë ulur shpenzimet e ngrohjes dhe energjisë krahasuar me vitin 2011.





Banka ProCredit për “Vrapo për paqe dhe tolerancë”

Ngjarja më e madhe sportive, gjysmë maratona ndërkombëtare Prishtina 2018, u organizua edhe këtë vit për të tetëmbëdhjetën herë me rradhë. Me moton, "vrapo për paqe dhe tolerancë", ky aktivitet mbledhi mijëra atletë nga vendi dhe bota.

ProCredit Bank është mbështetëse tradicionale e kësaj ngjarjeje të rëndësishme sportive në vend, e cila i kontribuon imazhit të sportit Kosovar.



“Coca-Cola HBC Kosova” në përkrahje të rinisë dhe ruajtjes së mjedisit

Në kuadër të aktiviteteve të përgjegjësisë shoqërore, Coca-Cola HBC Kosova, gjatë periudhës së fundit ka implementuar dy projekte të cilat kanë për qëllim të japin kontributin e kompanisë në dy fusha të cilat edhe janë fusha me prioritet, atë të mjedisit dhe rinisë. Njëri projekt ishte mbjellja e drunjëve në hapësira publike për ditën e tokës. Aktiviteti që u organizua nga Komuna e Prishtinës, u përkrah nga Coca-Cola HBC, me mbjelljen e 50 drunjve.

Projekti tjetër, shumë i rëndësishëm për kompaninë është “Coca-Cola përkah Rininë”. Ky projekt u zhvillua për 5 javë rresht, ku u trajnuan 150 të rinj të papunë.

Qëllimi kryesor i programit “Coca-Cola përkrah Rininë” është ofrimi i mundësisë të rinjve për tranjim, këshillim dhe mbështetje duke i ndihmuar ata të jenë të përgatitur për punësim kuptimplotë.




KOSTT vazhdon përkrahjen për fëmijët e Kosovës

Në vazhden e përgjegjësisë sociale, KOSTT sh.a konfirmoi edhe një herë përkushtimin për të kontribuar në mirëqenien e shoqërisë sonë duke dhënë përkrahje financiare për fëmijët e diagnostifikuar me kancer si dhe fëmijët e porsalindur që përballen me probleme shëndetësore.

Në kuadër të kësaj, KOSTT është bërë pjesë e iniciativës së komunitetit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim BERZH (EBRD Community Initiative) për të mbledhur fonde për sigurimin e medikamenteve për fëmijët e diagnostifikuar me kancer që trajtohen në Klinikën Pediatrike Onkologjike në QKUK, përmes fondacionit "Care for Kosovo Kids" (CfKK/FKfK). Ky Fondacion që nga viti 2013 është i angazhuar në shpëtimin e jetës së fëmijëve, duke siguruar përmes donacioneve trajtimin e nevojshëm për 60 fëmijë, çdo vit.

KOSTT gjithashtu ka dhënë donacion në përkrahje të fëmijëve të porsalindur me probleme shëndetësore që trajtohen në Klinikën e Neonatologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, përmes fondacionit "Action for Mothers and Children" (AMC). Fondacioni AMC zhvillon programe të ndryshme në përkrahje të përmirësimit të kujdesit të grave shtatzëna dhe foshnjave të lindura para kohës.



KOSTT ndër kompanitë e para publike vendore që çertifikohet me tri standarde ndërkombëtare

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a, ka pranuar tri çertifikata ndërkombëtare nga kompania britaneze QEC-EAS International Control and Certification.

KOSTT u çertifikua për herë të parë me Standardin e Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015 si dhe Standardin e Sigurisë dhe Shëndetit në punë OHSAS 18001:2007, derisa që nga viti 2010 KOSTT është çertifikuar në mënyrë të vazhdueshme me standardin ndërkombëtar për menaxhim të cilësisë ISO 9001:2008, derisa tani u certifikua me versionin më të ri të këtij standardi ISO 9001:2015.

Standardi ISO 14001:2015, është standardi më i njohur ndërkombëtar i cili i përcakton kriteret sipas të cilave kompanitë e vendosin

sistemin e menaxhimit mjedisor të veprimtarisë së tyre.

Ndërsa, përmes aplikimit të kriterëve të standardit të njohur ndërkombëtar OHSAS 18001:2007 dhe në pajtim me legjislacionin vendor, KOSTT ka siguruar mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm për të gjithë punonjësit, kontraktorët dhe vizitorët të cilët përdorin hapësirat dhe pajisjet e KOSTT.

Në përkushtimin e vazhdueshëm për ngritjen e cilësisë së punës dhe me qëllim të zbatimit efikas, KOSTT ka ndërtuar dhe mirëmban Sistemin e Integruar të Menaxhimit (SIM), duke përfshi Standardin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, Standardin e Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015 si dhe Standardin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë OHSAS 18001:2007..



Meridian Express dhe Buka Bakery mbështesin Ditën Botërore të Autizmit

Në Ditën Ndërkombëtare të Autizmit, BUKA Bakery dhe Meridian Express kanë përkrahur aktivitetin e organizuar nga shoqata Autizmi Flet Kosovë. Aktiviteti kishte moton "Natyre në Autizëm" dhe u organizua për të shënuar këtë ditë si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit për autizmin.



Meridian Express dhuron 1,506 euro për shëndetin e nënave dhe fëmijëve

Ditën Ndërkombëtare të Autizmit, BUKA Bakery dhe Meridian Express kanë përkrahur aktivitetin e organizuar nga shoqata Autizmi Flet Kosovë. Aktiviteti kishte moton "Natyre në Autizëm" dhe u organizua për të shënuar këtë ditë si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit për autizmin.



Meridian Express përkrahu aktivitetin e komunës për Ditën e Tokës

Meridian Express e ka mbështetur aktivitetin e Komunës së Prishtinës për pastrimin e lagjeve, fshatrave dhe qytetit me 50 vullnetarë dhe dhjetëra fidane të reja të mbjellura. Rrjeti më i madh i marketeve në Kosovë, Meridian Express, i është bashkëngjitur aktiviteteve të Komunës së Prishtinës për pastrimin e ambientit dhe mbjelljes së fidaneve të reja në lagje të ndryshme të qytetit. Përveç mbështetjes zyrtare të aktiviteteve, 50 punëtorë të Meridian Express i janë bashkëngjitur aktiviteteve për Ditën e Tokës.



Banka Raiffeisen dhuron pajisjen për diagnostifikimin e sëmundjeve të zemrës tek foshnjët

Aksioni për Nëna dhe Fëmijë së bashku me partnerin Bankën Raiffeisen në Kosovë e shënuan 1 Qershorin, Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, pak më ndryshe! Ata bënë dorëzimin e pajisjes Ehosonograf në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, pajisje kjo që do të mundësojë një shërbim të ri për fëmijët në Klinikën e Neonatologjisë në Prishtinë, duke përcuar kështu porositë e mbrotjes dhe promovimit të të drejtave shëndetësore për fëmijët.

Pajisja Ehosonograf mundëson diagnostikimin e të gjitha sëmundjeve të zemrës tek foshnjët, gjakderdhjeve të brendshme, infeksioneve, anomalive të sistemit nervor qendror, anomalive të sistemit urogenital, funksionimin e zorrëve dhe shumë sëmundje të tjera. Me dorëzimin e Ehosonografit ky shërbim dhe diagnostikim do mundësohet tani në Klinikën e Neonatologjisë në QKUK.



"Banka Raiffeisen vazhdimisht i ka kushtuar vëmendje të veçantë përkrahjes së shëndetësisë. Meqenëse shëndetësia është një fushë më specifike, na ka ndihmuar shumë bashkëpunimi që kemi me organizatën Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, përmes së cilës edhe e kemi realizuar këtë donacion. Ne jemi shumë të kënaqur që kjo pajisje do t'i mundësojë Klinikës Neonatologjike të ofrojë shërbime të reja që deri më tani nuk janë ofruar ndërsa Banka Raiffeisen do të vazhdojë të shikojë për mundësi të tjera për ta ndihmuar shëndetësinë," u shpreh Z. Robert Wright, Drejtor i Bankës Raiffeisen në Kosovë.

Sharrcem organizoi aktivitetin "Dhuro Gjak, Dhuro një Jetë, Mbro Shëndetin tënd"

Kompania e çimentos Sharrcem në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, ka organizuar dhurimin e gjakut nga punëtorët dhe menaxhmenti i Sharrcem, si përgjigje ndaj fushatës vetëdijësuese për dhurimin vullnetar të gjakut, që do të shërbejë për trajtimin e rasteve në nevojë në qendrat emergjente spitalore. Në kompaninë Sharrcem, që nga viti 2002 ka filluar kjo iniciativë dhe Akoma po vazhdon ky aksion humanitar.



Sharrcem për Ditën Botërore të Mjedisit: “Lidhja e njerëzve me natyrën”



Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, më 5 qershor, Sharrcem - Departamenti i Mjedisit, zhvilloi takime të përbashkëta me përfaqësuesit e Bashkisë së Hanit të Elezit dhe pjestarëve të tjerë relevantë, në mbështetje të iniciativës "Lidhja e njerëzve me natyrën" - temë globale e këtij viti për Ditën Botërore të Mjedisit 2018.

Sharrcem u bashkua në mbështetje të këtij aktiviteti duke ofruar burime dhe materiale të cilat ishin një ndihmë e madhe për zhvillimin e kampanjës, si qese letre, doreza, etj. Sharrcem, si një kompani përgjegjëse ndaj mjedisit, iu bashkua iniciativës duke mobilizuar qytetarët e Hanit të Elezit, së bashku me institucionet dhe palët e ndryshme të interesit, duke pastruar deponitë e paligjshme në komunën e Hanit të Elezit, të cilat ishin krijuar kryesisht pranë Lepencit.



Përgatitur nga Oda Ekonomike Amerikane
në Kosovë për Rrjetin CSR të Kosovës

Realizuese: Jora Lumezi